



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 14 të Ligjit mbi tokën ndërtimore, "G. zyrtare e Kosovës nr.14/80 dhe 42/86" dhe të nenit 32, pika 32.1, shkronja e të Statusit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E SHKOLLËS SË MESME TË
TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË PRISHTINË

Neni 1

- 1.1 Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shkollës së Mesme të Teknologjisë Informative në Prishtinë.
- 1.2 Lokacioni nga alinea 1 i këtij neni, përfshin pjesën e ngastrës kadastrore nr. 2913, në sipërfaqe prej 1.05,00 ha, Zona Kadastrore –Prishtinë.

Neni 2

Ndërtimi i objektit sipas këtij Vendimi, do të bëhet në bazë të programeve dhe përmbajtjeve tjera, të nevojshme për objekte me destinime të tilla, të hartuara nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës.

Neni 3

- 3.1 Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.
- 3.2 Nga aspekti i realizimit të lokacionit do të kujdeset Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, nga aspekti i realizimit të objektit do të kujdeset Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës e Komunës së Prishtinës.
- 3.3 Sektori i kadastrit do t'i kryejë veprimet procedurale të nevojshme nga përgjegjësia e tij për zbatimin e këtij Vendimi.

Neni 4

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe pjesa tekstuale dhe grafike e situacionit të lokacionit të dhënë në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.353-1022, më 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr.Isa Mustafa